

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLICA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
 AGJENCIA PËR NDËHMË JURIDIKE FALAS  
 AGENCIJA ZA BESPLATNU PRAVNU POMOĆ  
 AGENCY FOR FREE LEGAL AID

Nr./Br./No. 236-02 Nr./Br./str./No./pg. 08

Data/Datum/Date 23.11.2020

PRISHTINË-PRISHTINA-PRISTINA

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLICA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
 Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo  
 Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije  
 Ministry of Finance  
 Arkiva - Arhiva - Archive

Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit 01 Nr. Prot. Sr. Prot. Prot. No: 2112

Nr. i faqeve Broj stranica No. pages: 7 Data Datum Date: 23.11.2020

Hyrëse PRISHTINË/A



REPUBLIKA E KOSOVËS  
 KOMUNA GLOGOC  
 MUNICIPAL GLOGOC

Nr. 400/01-51832

01 Më On. 30/11/2020

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**Memorandum i Mirëkuptimit për Mbështetjen e Zyrtarëve të Ndihmës Juridike të**  
**Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas**

ndërmjet

**Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas**

- në tekstin e mëtejshëm e referuar si "ANJF" -

dhe

**Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës**

- në tekstin e mëtejshëm e referuar si "MF"

dhe

Komunës së Fushë Kosovës

Komunës së Drenasit

Komunës së Suharekës

Komunës së Dragashit

Komunës së Istogut

Komunës së Deçanit

Komunës së Kamenicës

Komunës së Graçanicës

Komunës së Malishevës

Komunës së Skënderajt

Komunës së Zveçanit

Komunës së Mitrovicës së Veriut

Komunës së Zubin Potokut

Komunës së Leposaviqit

## 1. Palët

Ky Memorandum i Mirëkuptimit (në tekstin e mëtejme i referuar si "MM") nënshkruhet ndërmjet palëve të lartpërmendura për mbështetjen nga buxheti i Republikës së Kosovës për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas.

## 2. Sfondi

Sipas Ligjit nr. 04/ L-017 për Ndihmë Juridike Falas, parashikohet që ndihma juridike falas të sigurohet në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Ndihma juridike falas është kategori kushtetuese e paraparë me nenin 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm). Kjo dispozitë kushtetuese ka paraparë që "ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi".

ANJF në fillim të punës së saj, veprimtarin e saj e ushtronte përmes pesë zyra rajonale për ndihmë juridike falas, që mbulonin Prishtinën, Pejën, Prizrenin, Gjilanin dhe Mitrovicën.

Obligimi ligjor që ndihma juridike falas të ofroj në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, nuk arrihej përmes këtyre zyrave dhe qytetaret e komunave tjera ishin në pamundësi për të realizuar të drejtat e tyre dhe për shkak të distancës së largët me zyrat statike u mohoj qasja e barabartë në drejtësi

Me mbështetjen e UNDP-së, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas arriti të hapte edhe 8 zyra për ndihmë juridike falas, si zyra mobile siç është paraparë në Ligjin për Ndihmën Juridike Falas. Bazuar në statistika, mund të shihet se këto zyra kishin një ndikim të madh në ofrimin e qasjes në drejtësi për qytetaret që nuk kishin mjete të mjaftueshme financiare për të realizuar të drejtat e tyre.

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas shtyu idenë e ndarjes së buxhetit më të lartë për t'i mbajtur këto zyra, por arriti të siguronte mjete financiare vetëm për zyrën rajonale për ndihmë juridike falas në Ferizaj dhe Gjakovë.

Për arsye të pamjaftueshmërisë së buxhetit të ndarë për ANJF si dhe me qëllim të zbatimit të obligimeve kushtetuese dhe ligjore, Agjencia ka arritur që me ndihmën e donatorit GIZ nga viti 2018, të shtrihet dhe të ofroj ndihmë juridike falas përmes Zyrave Mobile për Ndihmë Juridike Falas (ZMNJF) në 14 (katërmëdhjetë) komunat në vijim: Fushë-Kosovë, Drenas, Deçan, Istog,

Suharekë, Dragash, Mitrovicë Veriore, Zveçan, Leposaviq, Zubin-Potok, Malishevë, Graçanicë, Skenderaj dhe Kamenicë.

***Objektivi i MM-së ne mes te ANJF-së dhe GIZ***

Qëllimi i projektit është të mbështetet Agjencia për Ndhimë Juridike Falas në mënyrë që:

- Të rritet qasja në drejtësi për qytetarët në zonat e thella dhe në zonat ku nuk ka zyrë të Ndhimës Juridike Falas
- Të rritet vetëdijesimi për ekzistencën e Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas
- Të përmirësohen kapacitetet e zyrtarëve të Ndhimës Juridike duke marrë parasysh Ligjin e miratuar rishtazi për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe ligjet e tjera përkatëse me plotësim/ndryshime.

Në këtë drejtim, Agjencia për Ndhimë Juridike Falas, duke marrë parasysh projektin aktual kornizë, kërkon mbështetje për punësimin e 8 zyrtarëve të ndihmës juridike për të mbuluar 14 komuna, duke hapur zyra mobile për ndihmë juridike falas që do të mbulojnë zonat e mëposhtme të thella dhe me largëta nga Zyrat Rajonale per Ndihme Juridike Falas:

- Komuna e Fushë Kosovës
- Komuna e Drenasit
- Komuna e Suharekës
- Komuna e Dragashit
- Komuna e Istogut
- Komuna e Deçanit
- Komuna e Kamenicës
- Komuna e Graçanicës
- Komuna e Malishevës
- Komuna e Skënderajt
- Komuna e Zveçanit
- Komuna e Mitrovicës së Veriut
- Komuna e Zubin Potokut
- Komuna e Leposaviqit

Rajoni i Prishtinës numëron 7 (shtatë) komuna si Prishtinë, Podujevë, Lipjan, Kastriot (Obiliq), Drenas, Fushë-Kosovë dhe Graçanicë.

Në rajonin e Prishtinës, Ndihma Juridike Falas ofrohet përmes Zyrës Rajonale për Ndihmë Juridike Falas (ZRNJF), në Prishtinë e cila ofron Ndihmë Juridike Falas për qytetarët e komunave të Prishtinës, Podujevës, Lipjanit dhe Obiliqit.

Zyrat Mobile për Ndihmë Juridike Falas (ZMNJF), në komunat e Fushë-Kosovës, Drenasit dhe Graçanicës të cilat mbështeten nga GIZ, nga 1 Janari 2021, sigurohet qëndrueshmëria e ZMNJF në buxhetin e ANJF-së.

Rajoni i Prizrenit numëron 4 (katër) komuna si Prizreni, Theranda (Suharekë), Dragash dhe Mamusha.

Në rajonin e Prizrenit, Ndihma Juridike Falas ofrohet përmes Zyrës Rajonale për Ndihmë Juridike Falas (ZRNJF) në Prizren e cila ofron Ndihmë Juridike Falas për qytetarët e komunave të Prizrenit dhe Mamushës.

Zyrat Mobile për Ndihmë Juridike Falas (ZMNJF), në komunat e Therandës (Suharekë) dhe Dragashit të cilat mbështeten nga GIZ, nga 1 Janari 2021, sigurohet qëndrueshmëria e ZMNJF në buxhetin e ANJF-së.

Në rajonin e Pejës, Ndihma Juridike Falas ofrohet përmes Zyrës Rajonale për Ndihmë Juridike Falas (ZRNJF) në Pejë e cila ofron Ndihmë Juridike Falas për qytetarët e komunave të Pejës, Klinës dhe Junikut.

Zyrat Mobile për Ndihmë Juridike Falas (ZMNJF) në komunat e Deçanit dhe Istogut nga 1 Janari 2021, sigurohet qëndrueshmëria e ZMNJF në buxhetin e ANJF-së.

Në rajonin e Mitrovicës, Ndihma Juridike Falas ofrohet përmes Zyrës Rajonale për Ndihmë Juridike Falas (ZRNJF), në Mitrovicë e cila ofron Ndihmë Juridike Falas për qytetarët e komunave të Mitrovicës dhe Vushtrrisë. Zyrat Mobile për Ndihmë Juridike Falas (ZMNJF) në komunat e Skenderajt, Mitrovicë Veriore, Lepsaviq, Zveçan dhe Zubin-Potok nga 1 Janari 2021, sigurohet qëndrueshmëria e ZMNJF në buxhetin e ANJF-së.

Në rajonin e Gjilanit, Ndihma Juridike Falas ofrohet përmes Zyrës Rajonale për Ndihmë Juridike Falas (ZRNJF) në Gjilan, e cila ofron Ndihmë Juridike Falas për qytetarët e komunave të Gjilanit, Vitisë, Artanës (Novobërdë), Klllokotit, Ranillugut dhe Parteshit.

Zyrat Mobile për Ndhimë Juridike Falas (ZMNJF) në komunën e Kamenicës nga 1 Janari 2021, sigurohet qëndrueshmëria e ZMNJF në buxhetin e ANJF-së.

Në rajonin e Gjakovës, Ndhimja Juridike Falas ofrohet përmes Zyrës Rajonale për Ndhimë Juridike Falas (ZRNJF) në Gjakovë, e cila ofron Ndhimë Juridike Falas për qytetarët e komunës së Gjakovës dhe asaj të Rahovecit.

Zyra Mobile për Ndhimë Juridike Falas (ZMNJF) në komunën e Malishevës nga 1 Janari 2021, sigurohet qëndrueshmëri e ZMNJF në buxhetin e ANJF-së.

### 3. Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është sigurimi i qasjes së barabarte në drejtësi për qytetarët e këtyre komunave, duke siguruar qëndrueshmërinë e zyrave mobile për ndihmë juridike falas, si dhe përkushtimi i palëve për mbështetjen e zyrtarëve të ndihmës juridike të ANJF-së për të kaluar në buxhetin e Kosovës nga 1 janari 2021 dhe në vazhdim.

MM-ja për ndarje të buxhetit për 8 zyrtarë në komunat e lartpërmendura përfshin veçanërisht përkushtimin e MF-së, Komunave, dhe ANJF-së, për sa vijon:

1. Ministria e Financave do të ndajë buxhetin nga 1 janari 2021 e në vazhdim, për mbulimin e shpenzimeve për paga, tatime dhe kontribute pensionale për 8 (tetë) zyrtarë të ndihmës juridike falas me koeficientin 7, që aktualisht financohen nga GIZ deri 31.12.2020, me numrin e kontratës **83356144** në komunat e lartpërmendura;
2. Komunat marrin përsipër t'u sigurojnë zyrtarëve të ndihmës juridike hapësirë pune pa kosto;
3. ANJF-ja merr përsipër që materialet administrative dhe të zyrës të sigurohet prej tyre në përputhje me nevojat e tyre;

#### **4. Garancitë dhe detyrimet**

Secila palë i garanton palës tjetër se ka fuqi dhe autoritet të plotë për ta lidhur dhe për të zbatuar këtë Memorandum të Mirëkuptimit të vendosur sipas klauzoleve të përgjithshme të përmendura në këtë MM

Përmbajtja e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit hartohet me pëlqimin dhe miratimin e palëve nënshkruese.

Asnjëra palë nuk do të ketë të drejtë të mbështetet në ndonjë marrëveshje mirëkuptim ose aranzhim që nuk është përmendur shprehimisht në këtë MM në lidhje me mbështetjen për zyrtarët e ndihmës juridike të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas.

Asnjëra nga palët nuk ka asnjë detyrim ndaj palëve të treta ose ndaj dikujt që shkel këtë MM duke e keqpërdorur qëllimin e arritjes së këtij memorandumi, siç thuhet në nenin 3 të këtij memorandumi.

#### **5. Afati i këtij Memorandumi i Mirëkuptimit**

Ky Memorandum i Mirëkuptimit është me vullnet të lirë dhe do të ketë validitet pa asnjë kufizim, me qëllim të mbështetjes së zyrtarëve të ndihmës juridike të ANJF-së.


#### **6. Rregullimi i Marrëveshjes**

Në rast se dispozitat e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit nuk e çojnë më tej arritjen efektive të qëllimit të përcaktuar në nenin 3, atëherë ANJF-ja, MF-ja, dhe Komunitat, mund t'i rregullojnë ose ndryshojnë këto dispozita me pëlqim të ndërsjellë. Çdo ndryshim do të bëhet me shkrim.

#### **7. Hyrja në fuqi**

Memorandumi i Mirëkuptimit hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët. Ai do të hartohet në gjashtëmbëdhjetë ekzemplarë origjinalë dhe në dy gjuhë - shqip dhe serbisht, me dy ekzemplarë për çdo palë.

Anita Alaj Kalanderi  
Drejtoreshë Ekzekutive  
Për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas



Data/Nënshkrimi

Hykmete Bajrami  
Ministre  
Për Ministrinë e Financave



23.11.2020

Data/Nënshkrimi

Burim Berisha  
Kryetar  
Komuna e Fushë Kosovës



Ramiz Lladrovci  
Kryetar  
Komuna e Drenasit



Bali Muharremaj  
Kryetar  
Komuna e Suharekës



Shaban Shabani  
Kryetar  
Komuna e Dragashit



Haki Rugova  
Kryetar  
Komuna e Istogut

Bashkim Ramosaj  
Kryetar  
Komuna e Deçanit

Qendron Kastrati  
Kryetar  
Komuna e Kamenicës

Sërgjan Popoviq  
Kryetar

Komuna e Graçanicës

*për:* Ragip Begaj *FBerli*  
Kryetar  
Komuna e Malishevës



Bekim Jashari  
Kryetar  
Komuna e Skënderajt

Vuçina Janković  
Kryetar  
Komuna e Zveçanit

---

Kryetar  
Komuna e Mitrovicës së Veriut

Stevan Vulović  
Kryetar  
Komuna e Zubin Potokut

Zoran Todić  
Kryetar  
Komuna e Leposaviqit